

UDHËZUES PËR PLOTËSIMIN E FORMULARIT A1-Z

PËR REGJISTRIMIN E NXËNËSVE PËR PROVIMET E MATURËS SHTETËRORE 2009

I. UDHËZIME TË PËRGJITHSHME

- 1. Formulari A1-Z;** plotësohet për tu regjistruar në Maturën Shtetërore 2009, **VETËM** nga:
Kandidatët që kanë marrë pjesë në provimet me zgjedhje të Maturës Shtetërore 2006, 2007, 2008. dhe që duan të mbartin, njëerën ose të dyja lëndët me zgjedhje, në Maturën Shtetërore 2009.
- 2. Formulari A1-Z,** të plotësohet me shkronja të mëdha (kapitale).
- 3. Formulari A1-Z,** do të konsiderohet i vlefshëm **VETËM** nëse ai është plotësuar në mënyrë të saktë dhe të kuptueshme. Në rast të kundërt ai do të konsiderohet i pavlefshëm dhe nxënësi ose kandidati humbasin të drejtën e regjistrimit.
- 4.** Pasi të jenë plotësuar **Formularët A1-Z,** të dorëzohen pranë **Komisionit Shkollor të Maturës - Shtetërore (KSHMSH),** ku keni mbaruar shkollën.
- 5.** Në rast se nxënësi ose kandidati, ka bërë gabime në plotësimin e formularit ata mund të plotësojnë një Formular tjetër **A1-Z,** i cili zëvendëson të parin. Zëvendësimi i formularëve mund të pranohet nga **Komisioni Shkollor i Maturës -Shtetërore (KSHMSH),** vetëm brenda afatit të dorëzimit të tij (10 mars 2009). Pas këtij afati nxënësi ose kandidati **NUK** ka të drejtë të bëjë ndryshime të tjera.
- 6.** Plotësimi dhe dorëzimi i **Formularëve A1-Z,** fillon me datë **20 shkurt 2009** dhe përfundon me datë **10 mars 2009.**
- 7. Formularët A1-Z,** pas plotësimit kontrollohen me kujdes për saktësinë dhe më pas firmosen nga nxënësi ose kandidati, mësuesi kujdestar dhe drejtori i shkollës. Për kandidatët që kanë mbaruar para vitit 2009, drejtori i shkollës ngarkon një mësues që do luajë rolin e mësuesit kujdestar.
Çdo formular duhet të vuloset me vulën e shkollës

II. UDHËZIME TË DETAJUARA PËR PLOTËSIMIN E FORMULARIT

Në hapësirat e lëna bosh tek Formulari **A1-Z,** plotësoni:

1. Shkruani emrin e **DAR** ose **ZA,** ku ndodhet shkolla pranë së cilës ju do të jepni provimin;
2. Shkruani emrin e qytetit ose fshatit, në të cilin ndodhet shkolla juaj;
3. Shkruani emrin e shkollës ku ju keni kryer studimet;
4. Bazuar në tabelën Nr.1 (Indekset e profileve/degëve), gjeni indeksin e degës dhe shënoni numrin që përfaqëson dega që ju po ndiqni ose keni ndjekur, p.sh. Gjimnazi Drejtimi Shoqëror, në tabelë ka indeksin 02, në formular ju do shënoni numrin **02.** (*Plotësohet në bashkëpunim me mësuesin kujdestar*)

5. Shënohet ID që keni patur në Maturën Shtetërore 2006, 2007, 2008. Nëse jeni pajisur, dy a më shumë herë me ID, shënohet ID e vitit të fundit. (*Plotësohet në bashkëpunim me drejtorin e shkollës*).
6. Shënoni emrin tuaj Shënoni emrin e babait Shënoni mbiemrin tuaj
- Kujdes!** - të shënohen me shkronja kapitale dhe në përputhje me çertifikatën personale.
- të bëhet kujdes me emrat që përmbajnë shkronjat (**Ë**) dhe (**Ç**).
7. Shënoni datëlindjen tuaj, duke plotësuar me dy shifra ditën dhe muajin, (p.sh. 05/12/1989).
8. Vendosni një shenjë në formë kryqi në kutinë që i përket gjinisë suaj. P.sh. nëse i përkisni gjinisë femërore shënoni një kryq [X] në kutinë përbri fjalës “Femër”;
9. Shënoni vitin kur keni përfunduar studimet në shkollën e mesme, (p.sh., 2006, 2007, 2008).
10. Nxënësit që duan të vazhdojnë studimet jashtë shtetit shënojnë një kryq [X] në kutinë përbri PO.
11. Qarkoni IV ose V, sipas profilit të shkollës që keni kryer.
12. 1. Në hapësirat bosh, të shënohet emri i lëndës (lëndëve) me zgjedhje që do mbartet (mbarten) dhe vitin kur është dhënë provim kjo lëndë. Nëse lënda (lëndët) që do të mbartet (mbarten) janë dhënë provim më shumë se një herë, atëhere në formular duhet të shënohet viti i fundit kur është dhënë provim kjo lëndë.
P.sh., nëse do mbartni lëndën **Fizikë**, të cilën e keni dhënë provim dy herë, në MSH 2007 dhe MSH 2008, atëhere në formular duhet të shënoni vitin **2008**.
12. 2. - Nëse keni mbartur **dy lëndë me zgjedhje** nga Matura Shtetërore e viteve të mëparëshme, **kërkesa 12.2 nuk plotësohet**.
- Nëse keni mbartur **vetëm një lëndë me zgjedhje** nga Matura Shtetërore e viteve 2006, 2007, 2008, atëhere, në listën e lëndëve me zgjedhje, duhet të qarkoni **vetëm një lëndë me zgjedhje**. *Nëse lënda që keni mbartur është gjuhë e huaj, lënda që do të qarkoni, në listën e lëndëve me zgjedhje, nuk duhet të jetë gjuhë e huaj.*
- Nëse **NUK** keni mbartur lëndë me zgjedhje nga Matura Shtetërore e viteve 2006, 2007, 2008, atëhere duhet të qarkoni **dy lëndë me zgjedhje**, në listën e lëndëve me zgjedhje.
- Lëndët që do të qarkoni, nuk duhet të jenë të dyja gjuhë e huaj.** P.sh., nuk mund të qarkoni;
Anglisht dhe Frëngjisht, Anglisht dhe Italisht etj.

Shënim:

- Nxënësi, firmos në hapësirën e përcaktuar për të.
- Mësuesi, shkruan emrin dhe mbiemrin (me shkronja kapitale) dhe firmos në hapësirën e përcaktuar për të.
- Drejtori, shkruan emrin dhe mbiemrin (me shkronja kapitale) firmos dhe vulos me vulën e shkollës, në hapësirën e përcaktuar për të.

TABELA NR. 1

INDEKSET E PROFILEVE / DEGËVE TË SHKOLLAVE TË MESME 2009

INDEKSET	DEGËT
01	GJIMNAZI DREJTIMI NATYROR
02	GJIMNAZI DREJTIMI SHOQËROR
03	GJIMNAZI DREJTIMI I PËRGJITHSHËM
04	SH. M. P E PAPROFILIZUAR (PARA 2007)
05	GJIMNAZI ME KOHË TË SHKURTUAR
06	NATYROR 2 GJUHËSH FRANCEZE
07	SHOQËROR 2 GJUHËSH FRANCEZE
08	SHOQËROR 2 GJUHËSH ITALIANE
09	GJUHË E HUAJ ANGLISHT
10	GJUHË E HUAJ FRËNGJISHT
11	GJUHË E HUAJ GJERMANISHT
12	GJUHË E HUAJ SPANJISHT-RUSISHT
13	GJUHË E HUAJ ITALISHT
14	ARTISTIKE KOREOGRAFI
15	ARTISTIKE ARTE FIGURATIVE
16	ARTISTIKE MUZIKË
17	SPORTIVE FUTBOLL
18	SPORTIVE ATLETIKË
19	SPORTIVE VOLEJBOLL
20	SPORTIVE BASKETBOLL
21	PEDAGOGJIKE 4 VJEÇARE
22	PEDAGOGJIKE GREQISHT GJIROKASTËR
23	TEKNIKE 5 VJEÇARE(BANKA/TATIME/SIGURIME)
24	TEKNIKE EKONOMIKE 5 VJEÇARE TURIZËM
25	TEKNIKE PROFESIONALE 3+2 FERMER
26	TEKNIKE PROFESIONALE 3+2 HOTELERI TURIZËM
27	TEKNIKE PROFESIONALE 3+2 MAKINERI BUJQËSORE
28	TEKNIKE PROFESIONALE 3+2 TEKNOLOGJI USHQIMORE BYLMET MISH
29	TEKNIKE PROFESIONALE 3+2 TEKNOLOGJI USHQIMORE PIJE KONSERVA
30	TEKNIKE 5 VJEÇARE VETERINARI
31	TEKNIKE 5 VJEÇARE AGRO BIZNES
32	TEKNIKE 5 VJEÇARE ELEKTRIK I PËRGJITHSHËM
33	TEKNIKE 5 VJEÇARE ELEKTRONIKË
34	TEKNIKE 5 VJEÇARE ELEKTROTEKNIKË
35	TEKNIKE 5 VJEÇARE MEKANIK I PËRGJITHSHËM
36	TEKNIKE 5 VJEÇARE POLIGRAFIK
37	TEKNIKE 5 VJEÇARE PYJE
38	TEKNIKE 5 VJEÇARE TEKNIK GJEODET
39	TEKNIKE 5 VJEÇARE TEKNIK NDËRTIMI
40	TEKNIKE 5 VJEÇARE TEKNOLOGJI USHQIMORE
41	TEKNIKE 5 VJEÇARE TELEKOM
42	HARRY FULTZ MENAXHER AUTOMOBILASH
43	HARRY FULTZ BIZNES
44	HARRY FULTZ ELEKTRIKE
45	HARRY FULTZ ELEKTRONIKË
46	TEKNIKE 4 VJEÇARE (PARA 2007)
47	TEKNIKE PROFESIONALE ME KOHË TË SHKURTUAR
48	TEKNIKE PROFESIONALE 3+2 PERPUNIM DRURI
49	TEKNIKE PROFESIONALE 3+2 KONFEKSION-STILIM
50	PROFILI IM S'ËSHTË NË LISTË